



Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Fakulteti i Sigurisë Publike
Fakultet Javne Bezbednosti/Faculty of Public Safety

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë
Odeljenje za osiguranje kvaliteta/Division for Quality Assurance

Raporti i Vlerësimit të Lëndëve Mësimore, Performancës së Mësimdhënësve dhe Vetëvlerësimit të Studentëve në Arsimin e Lartë



Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

FSP: Fakulteti i Sigurisë Publike

ISP: Institucionet e Sigurisë Publike

PK: Policia e Kosovës

IPK: Inspektorati Policor i Kosovës

AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent

SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës

DK: Doganat e Kosovës

DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë

SMU: Sistemi i Menaxhimit Universitar

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	2
Hyrja	4
Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC	5
Realizimi i pyetësorit	5
Të gjeturat e pyetësorit.....	5
Vlerësimi i Lëndëve Mësimore.....	8
Vlerësimi për lëndët e përgjithshme dhe të specializuara.....	9
Vlerësimi për lëndët e praktikës profesionale – internshipit	10
Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve	12
Vetëvlerësimi i Studentëve	13
Komentet e përmbledhura.....	14
Rekomandimet	15

Hyrja

Arsimi i lartë në AKSP - Krahas aprovimit të Ligjit të AKSP-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: *“Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik”* implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimit u bë e mundur themelimi i Fakulteti i Sigurisë Publike gjegjësisht Arsimit të Lartë në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bolonjes, përkatësisht me EHEA standardet evropiane.

Sigurimi i cilësisë në AKSP - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në AKSP-ë dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative.

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë. Në këtë frymë janë krijuar pyetësor në cilësinë e mekanizmave matës dhe përmirësues në fushën e arsimit të lartë duke e vendosur studentin në qendër.

Qëllimi i raportit është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënien duke ofruar një analizë, të gjetura dhe rekomandime nga perspektiva e informatave të ofruara nga studentet e Fakultetit. Po ashtu përmes këtij raporti, ne ofrojmë një vetëvlerësim të studentëve të cilët e nxisin reflektimin kritik mbi mësimin e tyre, kompetencën e arritur dhe ofrojnë planifikime për të ardhmen në projektimin e rezultateve të të nxëniet, të cilat lehtësojnë vendosjen e studentit në qendër.

Në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda Akademisë, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, DSC-ja ka realizuar pyetësorin elektronik me studentët e FSP-së, në nivelin Bachelor, në përfundimin semestral dimëror dhe veror, si një proces tashmë i zakonshëm. I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur kredibilitetin dhe prestigjin e institucionit.

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë është një divizioni i cili në veprim është i pavarur dhe funksionon nën Zyrën e Drejtorit të përgjithshëm të AKSP-së dhe raporton direkt tek drejtori i përgjithshëm i AKSP-së. DSC angazhohet në rritjen e cilësisë në AKSP duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentet matëse të cilësisë të aprovuar në doracakun e cilësisë i cili rishikohet në baza të rregullta periodike konform ndryshimeve të reja dhe azhurnimeve të reja akterët relevant për të cilat DSC ofron raportet vlerësuese. DSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Drejtori i përgjithshëm i AKSP si dhe tek Dekani i FSP në raste të arsimit të lartë me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Realizimi i pyetësorit

DSC pas përfundimit të semestrit dimëror dhe atij veror të vitit akademik 2022-2023, ka lansuar pyetësorët elektronik për të gjithë studentët e nivelit Bachelor në FSP. Pyetësorët janë anonim dhe të formatit elektronik i adresuar përmes platformës së domenit dsc.aksp@aksp-ks.org e cila njëherësh është e ndërlidhur me përpunimin e të dhënave elektronike duke shfrytëzuar sistemet e licencuara të google forms. Studentët janë përgjigjur përmes sistemit elektronik për vlerësimin e lëndës mësimore, performancës së mësimdhënësit nga ana e studentëve si dhe kanë reflektuar përmes vetëvlerësimit mbi nivelin e mësimnxënijes së tyre. Kjo shërben si pika kyçe e vendosjes së studentit në qendër duke analizuar informatat e pranuar për hartimin e plotësimit/ndryshimeve në kuadër të programit.

Të gjeturat e pyetësorit


Pyetësorët elektronik të plotësuar nga ana e studentëve në FSP bazuar në të cilën neve konsiderojmë se kemi pas një pjesëmarrje prezantuese të mjaftueshme. DSC ka bërë shpërndarjen elektronike të pyetësorëve si dhe njoftimet paraprake dhe rikujtuese përmes SIS-sistemit elektronik. Gjegjësisht janë shpërndarë 75 pyetësor tek 60 student dhe janë pranuar gjithsejtë 4550 reagime. Të gjitha të gjeturat të cilat janë ofruar nga reagimet e studentëve kanë qenë të dhëna të sigura të ofruara në vlerësim, koment dhe propozimet e tyre kanë indikuar se studentët janë pjesë thelbësore në kontributin e tyre në përmirësimin e vazhdueshëm në kuadër të proceseve në FSP. Për të ofruar të dhëna më të detajuara, më poshtë do gjeni të gjeturat e ndara në raporte sipas drejtimeve të caktuara veq e veq. Ky raport njëherësh shprehë statistikën e përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve në nivel të fakultetit si dhe për secilin profesor. DSC dërgon gjetjet tek Dekani i FSP, dhe raportet si të tilla diskutohen me stafin akademik.

Në kuadër të vlerësimeve të pranuar nga studentët e Fakultetit, kemi këtë analizë tabelore të ndarë për vit akademik dhe për drejtime gjegjëse si në vijim:

Tabela e vlerësimeve të vitit akademik 2022 – 2023

Viti Akademik 2023- 2024	Vlerësimi i Lëndës Mësimore		Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësit		VetëVlerësimi i studentëve		Mesatarja e kënaqshmërisë	
							%	notë
Viti I - Semestri I - Drejtimi i pergjithshem	89.4%	4.5	89.4%	4.5	88.4%	4.4	89.1%	4.5
Viti I - Semestri II - Drejtimi i pergjithshem	97.5%	4.9	100.0%	5.0	94.0%	4.7	97.2%	4.9
Viti II - Semestri III - Drejtimi i pergjithshem	81.4%	4.1	82.2%	4.1	80.8%	4.0	81.5%	4.1
Viti II - Semestri IV - Drejtimi Policor	92.2%	4.6	92.2%	4.6	91.6%	4.6	92.0%	4.6
Viti II - Semestri IV - Drejtimi Emergjenca	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0
Viti III - Semestri V - Drejtimi Korrektues	92.0%	4.6	100.0%	5.0	82.8%	4.1	91.6%	4.6
Viti III - Semestri VI - Drejtimi Korrektues	89.2%	4.5	90.4%	4.5	88.0%	4.4	89.2%	4.5
Viti III - Semestri V - Drejtimi Policor	73.1%	3.7	73.7%	3.7	72.3%	3.6	73.0%	3.7
Viti III - Semestri VI - Drejtimi Policor	69.8%	3.5	67.8%	3.4	71.8%	3.6	69.8%	3.5
Viti III - Semestri V - Drejtimi Emergjent	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0
Viti III - Semestri VI - Drejtimi Emergjent	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0	100.0%	5.0
Viti IV - Semestri VI - Drejtimi Korrektues	93.6%	4.7	94.1%	4.7	94.4%	4.7	94.0%	4.7
Viti IV - Semestri VI - Drejtimi Doganor	88.9%	4.4	88.8%	4.4	88.4%	4.4	88.7%	4.4
Viti IV - Semestri VI - Drejtimi Policor	86.4%	4.3	86.4%	4.3	85.3%	4.3	86.0%	4.3
Mesataret e pergjithshme e kënaqshmërisë	88.9%	4.4	89.6%	4.5	87.9%	4.4	88.8%	4.4


Viti Akademik	perqindam	perqindam I	perqindam II	perqindam III	perqindam IV	perqindam V	perqindam VI	perqindam VII	perqindam VIII	perqindam IX
2022-2023	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2021-2022	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2020-2021	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2019-2020	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2018-2019	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2017-2018	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2016-2017	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2015-2016	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2014-2015	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2013-2014	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2012-2013	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2011-2012	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2010-2011	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2009-2010	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2008-2009	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2007-2008	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2006-2007	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2005-2006	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2004-2005	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2003-2004	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2002-2003	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2001-2002	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
2000-2001	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1999-2000	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1998-1999	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1997-1998	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1996-1997	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1995-1996	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1994-1995	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1993-1994	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%
1992-1993	98.6%	98.6%	98.6%	98.6%						



Vlerësimi i Lëndëve Mësimore

Në kuadër të vlerësimeve të pranura nga studentët e Fakultetit, nga fusha e vlerësimit të lëndëve mësimore kemi këtë analizë tabelore të ndarë për vit akademik dhe për drejtime gjegjëse si në vijim:

Tabela e vlerësimeve të lëndëve mësimore për vitin akademik 2022 - 2023



Struktura e lëndëve mësimore i janë përshtatur profilit të fushës së sigurisë publike i cili sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC), është kategorizuar në kodin **16.0 Fusha tjera të studimit**. Në fakt programi dhe lëndët mësimore i janë përshtatur nevojave të ISP-ve duke u ndarë në module të përgjithshme, të specializuara të profilit sipas drejtimeve dhe ato të moduleve praktike.

Vlerësimi për lëndët e përgjithshme dhe të specializuara

Lëndët kanë pas një rrjetëzim të përshtatshëm meqë programi ndahet në drejtime dhe ju përshtatet fushave profesionale të drejtimeve si; Policor, Korrektues, Emergjencia dhe Doganor.

Përmbajtja e lëndëve ka qenë e përditësuar sipas trendëve nga fusha e sigurisë të cilat njëherësh janë në përputhje të plotë me strategjitë e ISP-ve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të syllabusve, DSC ka vërejtur se në vazhden e përmirësimit është edhe implementimi i Taksonomisë së Bloomit, e cila është bërë pjesë e rishikimit periodik të lëndëve mësimore.

Metodat e mësimdhënies të përdorura në kuadër të lëndëve mësimore janë nga ato të leksioneve tradicionale e gjerë tek diskutimet në grup, punë praktike, projekte, dhe simulime. Studentët e Fakultetit përmes pyetësorit vlerësues për pjesën e vlerësimit të lëndëve mësimore janë deklaruar se objektivat e lëndës kanë qenë të sqaruar mirë nga mësimdhënësit dhe në përputhje me pritjet nga lënda mësimore duke nxjerr në pah rezultatet e të nxënit dhe vendosjen e studentit në qendër.

Rezultatet e të nxënit kanë qenë në rrjetëzim me lëndët dhe objektivat e programit mësimor duke avancuar njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencën profesionale. Mënyra e vlerësimit të përdorura nga mësimdhënësit kanë qenë moderne dhe të gërshetuara duke ofruar kohë dhe konsulta për studentët në nevojë.

Përmbajtja e lëndëve të shtjelluara ka qenë e nivelit profesional, në të gjithë shtrirjen e programit dhe lëndëve të ofruara përfshirë edhe ato të përgjithshme. Raportet e përveqshëm janë adresuar dhe është iniciuar themelimi i grupit punues në rishikimin e programit Bachelor duke reflektuar edhe në kuadër të syllabusve. Sa i përket lëndëve të specializuara, ato kanë rezultuar me një vlerësim të lartë në kuadër të zhvillimit profesional të studentëve të Fakultetit.

Vlerësimi për lëndët e praktikës profesionale – internshipit

Moduli i **Internshipit** në Fakultetin e Sigurisë Publike ka një rol shumë të rëndësishëm, sepse lidh në mënyrë praktike njohuritë teorike të fituara gjatë studimeve me punën reale në institucionet e sigurisë.

Janë zhvilluar 4 internshipe të ndara nëpër ISP sipas përcaktimit të procedurave dhe proceseve në kuadër të Manualit për Internship.

Vlerësimi i internshipit nga studentët në aspektin e nivelit të kënaqshmërisë ka rritur 92.45% ose 4.60 notë mesatare. Studentët kanë vlerësuar që në kuadër të pjesës së internshipit ka arritur të gërshetojnë pjesën teorike në aspektin praktik përmes angazhimit aktiv dhe në bashkëpunim të ngushtë me mentorin e pjesës praktike të internshipit, sipas raporteve të ofruara nga Koordinatori i internshipit. Plani dinamik është zbatuar në detaj në baza ditore. Studentët kanë shprehur vetëbesim në implementimin e pjesës praktike dhe kanë arritur me sukses të përmbushin rezultatet e pritura të internshipit.

Aktivitetet e AKSP-së në organizimin e internshipit, është arritur një vlerësim i lartë në aspektin e organizimit të internshipit nga Akademia me një mesatare të kënaqshmërisë prej 85.85 % ose 4.29 notë mesatare. Akademia në kuadër të aktiviteteve të saja në fazën përgatitore për implementimin e Internshipit ka ndjekur planin e saj dinamik dhe ka zhvilluar takimet njoftuese me student dhe institucionet nikoqire duke lehtësuar dhe përgatitur deri në detaj fazën e implementimit të internshipit. Po ashtu përgjatë fazës së internshipit ka vizituar studentet dhe nga afër është njoftuar me nevojat e tyre dhe procesin implementues të cilat i ka adresuar edhe përmes raporteve nga Koordinatori i internshipit të Akademisë.

Aktiviteti i institucionit përkatës në aranzhimin e internshipit vlerësimi i arritur është i lartë me një mesatare prej 84.55 % ose 4.22 notë mesatare. Institucionet nikoqire për studentet e Fakultetit në kuadër të implementimit të pjesës praktike - internshipit kanë qene të përgatitura për pranimin e studenteve sipas njoftimeve paraprake nga Akademia. Po ashtu vlen të ceket një nivel i lartë i gatishmërisë së institucioneve nikoqire për pranim të studenteve të FSP. Bashkëpunimi ka qene esencial dhe i deshmuar me mentoret e caktuar, e cila e ka lehtësuar fidbekun-informaten kthyesë në çdo kohë.

Vlerësimi i arritjes së rezultateve të internshipit vlerësimi i arritur është i lartë me një mesatare prej 84.55% ose 4.39 notë mesatare. Studentet kanë vlerësuar se janë arritur në mënyrën më të mirë të mundshme të gjitha rezultatet e pritshme në kuadër të internshipit. Të gjitha aktivitetet kanë qene të arritshme, dhe me kritere të qarta vlerësimi. Internshipi ka arritur të plotësojë shkathtësitë praktike të studenteve duke i përgatitur për aplikim në të ardhmen.


Fidbeku/Informata kthyesë për mentorin vlerësimet e përveqshme për mentor janë adresuar dhe në rrafshin e përgjithshëm mund të deklarojmë që kemi pranuar një vlerësim të lartë duke dëshmuar në nivelin të lartë profesional të zyrtarëve të sigurisë publike, produkt ky i Akademisë. Mesatarja e kënaqshmërisë është 87.8 % ose 4.48 notë mesatare e vlerësimit. Studentet kanë vlerësuar shumë lartë nivelin e kënaqshmërisë së angazhimit, përkushtimit dhe mbi të gjitha udhëzimeve që mentorët kanë ofruar në kuadër të periudhës praktike të internshipit.

Studentet kanë vlerësuar lartë rolin e mentorit si esencial në përditshmërinë e tyre në internshipin përmes shpjegimeve shtese dhe të prekshme në praktik, formave krahasimore të rasteve dhe praktikave të ndryshme në terren si dhe kohës së përkushtuar për secilin në formatin individual për ta duke siguruar se detyrat ditore përmbushen në tërësi dhe duke i tejkaluar të priturat. E tjerë, fal profesionalizmit dhe shkathtësive komunikuese të mentorit në fushën përkatëse në baza ditore.

Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve

Vlerësimi fokusohet në performancën e mësimdhënësve të Fakultetit, duke vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, angazhimin e tyre dhe aftësitë për të krijuar një mjedis stimulues për studentët. Sipas mesatares së përgjithshme vlerësuese nga studentët kemi 90.3 % nivelin e kënaqshmërisë së studentëve në performancën e mësimdhënësve ose notë mesatare 4.51.

Tabela e vlerësimeve të performancës së mësimdhënësve për vitin akademik 2022 – 2023



Në formatin e përgjithshëm të vlerësimit, mësimdhënësit e Fakultetit nga fusha e ngushtë profesionale kanë treguar nivel të lartë të njohurive dhe të njëjtat i ka transferuar tek studentët duke përdorur metodologji të dëshmuar të ligjërimit. Po ashtu është vlerësuar edhe koha e mjaftueshme e ofruar për pyetje dhe sqarime shtesë për student.


Sipas vlerësimit te pranuar, mësimdhënësit kanë treguar nivel të lartë përgatitor nga fusha e lëndëve të përgjithshme, të specializuara dhe ato të pjesës praktike.

Performanca e mësimdhënësve është vlerësuar lartë. Studentët kanë vlerësuar se është arritur gërshetimi teorikë dhe praktik gjatë ligjërimit si dhe gatishmëria e mësimdhënësve për të ofruar ndihmë dhe konsultime shtesë për të gjithë studentet. Mësimdhënësit kanë përdorur metodologji të dalluar të ligjërimit dhe nuk kanë munguar aktivitetet jashtë kurrikulare të vetë-organizuar nga mësimdhënësit e Fakultetit.

Vetëvlerësimi i Studentëve

Vlerësimi në vetë pasqyron mënyrën si studentët e vlerësojnë veten në raport me mësimnxënijen, përpjekjet dhe arritjet e tyre akademike. Sipas mesatares së përgjithshme vetë vlerësuese kemi një nivel të lartë të kënaqshmërisë prej 88.48 % ose 4.42 notë mesatare.

Tabela e vetë vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2022 – 2023



Metodologjia e përdorur në mbledhjen dhe analizën e të dhënave gërsheton edhe vlerësimet akademike të diferencuara dhe jo të diferencuara në kuadër të të arriturave të studentëve të Fakultetit.

- Mesatarja e përgjithshme prej testet/provimeve dhe vlerësimit para Komisionit Vlerësues të Internshipit është: **8.11** nota mesatare

Në kuadër të procesit vetë-vlerësues nga ana e studenteve në rezultatet e përgjithshme dhe të transmetuara përmes mësimdhënies dhe performancës së mësimdhënësve tek mësimnxënien e studenteve në fazën përmbyllëse të vitit akademik, studentët kanë vlerësuar se kanë arritur të zhvillojnë njohuri të reja mbi konceptet dhe teoritë themelore dhe të specializuara.

Ata këto njohuri dhe shkathtësi i vlerësojnë si të zbatuara në kuadër të detyrave dhe vlerësimeve të implementuar konform ligjëratave të cilat kanë zhvilluar të menduarit kritik dhe kanë avancuar aftësitë e tyre të komunikimit në aspektin profesional.

Të gjitha testet, detyrat dhe vlerësimet kanë qenë në harmoni me ngritjen e kompetencës profesionale të tyre të ngushtë. Përkundër faktit që studentët e Fakultetit janë pjesëtar aktiv dhe kyç të sigurisë në vend, gjatë ngritjes së tyre profesionale i janë përgjigjur sfidave dhe kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë në vend duke shkëlqyer në menaxhim dhe dëshmi të shkathtësive të fituara në Fakultet dhe të implementuara në terren.

Komentet e përmbledhura

Studentët e Fakultetit në pjesën e dedikuar për komente kanë shfaqur sinqeritet dhe kanë ofruar propozimet e tyre të cilat ndërlidhen me procesin dhe ngritjen e tyre profesionale në fushat e caktuara të sigurisë publike. Në përgjithësi kemi pranuar komente pozitive për gjithë procesin e ligjëratave, ushtrimeve, dhe aktiviteteve në Fakultet dhe po ashtu studentët kanë vlerësuar gjithë menaxhmentin e fakultetit që kanë bërë një punë shumë të mirë në gjithë organizimin e mësimi. Ata kanë inkurajuar mësimdhënësit në vazhdimin e përkushtimit dhe motivimit të tillë për studentë duke pasur interaktivitet gjatë ligjëratave dhe duke vlerësuar çdo mendim. Në fakt pjesa e komenteve janë të gjeneralizuara në njohjen dhe paraqitjen profesionale të dëshmuar të mësimdhënësve në Fakultetin e Sigurisë Publike në Akademi.

Në total kemi pranuar dhe analizuar mbi 400 komente.

Rekomandimet

Divizioni për sigurimin e cilësisë në Akademi, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të nivelit Bachelor në Fakultet dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të Fakultetit që të merren hapat si më poshtë:

- Fakulteti dhe posaçërisht formati i drejtimeve gjegjëse inkurajohen të eksplorojnë mjediset e të nxënit virtual përmes mësimit online si dhe të ofrojnë mundësinë e ofrimit të qasjes në disa institucione publike jashtë domenit të internshipit për praktik, përmes vizitave brenda dhe jashtë vendit;
- Të investohet vazhdimisht në trajnime të stafit akademik për metoda të mësimdhënies, sidomos për lëndët e përgjithshme të cilat janë më shumë të aspektit teorik;
- Të pasurohet biblioteka me tituj të ri nga fusha e sigurisë publike;
- Stafi akademik të fokusohet rreth përmbajtjeve akademike, sidomos në zhvillimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të studentëve në FSP;
- Të rritet numri i bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve me IAL-të tjera, vendore dhe ndërkombëtare për të mundësuar mobilitet të studentëve;
- Të shqyrtohet mundësia e ri aranzhimit të orarit të ligjëratave në FSP;
- Shqyrtimin e mundësive të krijimit të aktiviteteve shtesë për student sidomos në krijimin e mjediseve efektive të të mësuarit;
- Ti kushtohet rëndësi të veçante procesit të rishikimit periodik të programit Bachelor sidomos tek lëndët e përgjithshme, përfshirë faktin se tash karshi formatit 4 vjeçar kemi edhe atë të akredituar me sistem 3 vjeçar;